

Koronavirusi: Informacion mbi vaksinimin në kantonin Zürich

Gjendja 01.09.2021

Vaksinimi është vullnetar dhe falas.

A mund të vaksinohem unë?

Po, mundeni, nëse

- jeni 12 vjeç ose më shumë
- nuk keni temperaturë ose ndonjë simptomë tjetër të COVID-19
- nuk jeni alergjike/alergjik ndaj ndonjë përbërësi të vaksinës (PEG)
- nuk jeni në izolim ose në karantinë

Gratë shtatzëna, personat alergjikë me reagime të rënda në të kaluarën dhe personat me imunosupresion të rëndë, para vaksinimit duhet të konsultohen me mjekun ose mjekun e tyre.

Nëse jeni shtatzënë ose jeni alergjike/alergjik ndaj ndonjë përbërësi të vaksinës, do t'ju duhet një certifikatë mjekësore për t'u vaksinuar në një qendër vaksinimi.

Çfarë duhet të kem parasysh, nëse jam ndërmjet moshës 12 dhe 15 vjeç?

Në takimin e vaksinimit adoleshentët duhet të shoqërohen nga prindi apo kujdestari ligjor, ose duhet ta sjellin të nënshkruar deklaratën e pëlqimit të Drejtorisë Shëndetësore. Deklarata mund të shkarkohet në Webfaqen [zh.ch/coronaimpfung](https://www.zh.ch/coronaimpfung).

Si duhet të veprojmë?

Të gjithë personat e moshës 12 vjeç e lart mund të regjistrohen dhe të caktojnë takim për vaksinim në [zh.ch/coronaimpfung](https://www.zh.ch/coronaimpfung).

Nëse keni nevojë për ndihmë: 0848 33 66 11

(Shpenzimet brenda shtetit jo më shumë se 0,08 franga/minuti)

Cilat të dhëna më duhen?

Të dhënat personale, emri, mbiemri dhe numri i Sigurimit Shëndetësor.

Ku mund të vaksinohem?



Qendrat e vaksinimit
për personat 16 vjeç e lart

Affoltern am Albis

Holiday Inn Express, Obstgartenstrasse 7 (deri më 29.10.21)

Bülach

Stadthalle, Allmendstrasse 8 (deri më 28.09.21)

Uster

Sportareal Buchholz, Hallenbadweg 4

Winterthur

Rieter-Areal Töss, Klosterstrasse 20/21

Zürich

Referenz-Impfzentrum der Universität Zürich, Hirschengraben 84
Stadtpital Triemli, Birmensdorferstrasse 497



Qendrat e vaksinimit
për adoleshentët 12 vjeç e lart

Uster Sportareal Buchholz, Hallenbadweg 4

Winterthur

Rieter-Areal Töss, Klosterstrasse 20/21

Zürich

Kinderspital «Kispi», Eingang Poliklinik, Steinwiesstrasse 75



Farmacitë

Personat e moshës 16 vjeç e lart mund të vaksinohen në farmacitë e përzgjedhura.



Pika të lëvizshme vaksinimi

Informohuni në [zh.ch/impfmobil](https://www.zh.ch/impfmobil) për orarin e vaksinimeve dhe vendndodhjen.



Kantoni Zürich
Drejtoria e Shëndetësisë

Informacione të mëtejshme:
[zh.ch/coronaimpfung](https://www.zh.ch/coronaimpfung)